



Video e shkurtër për historinë e të drejtave të njeriut

<https://www.youtube.com/watch?v=P9u5cOjwRCw>

PYETJET MË TË SHPESHTA LIDHUR ME NATYRËN, HISTORINË DHE EVOLUIMIN E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Çfarë janë të drejtat e njeriut?

Të gjitha qeniet njerëzore janë të barabarta në të drejta dhe dinjitet. Këto të drejta i përkasin të gjithë individëve për për shkak të natyrës së tyre njerëzore. Këto të drejta janë të formuluar dhe artikuluara në ata që ne quajmë Të Drejtat e Njeriut, dhe me anë të proceseve legislative janë përkthyer në të drejta ligjore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

A pranohen universalisht të drejtat e njeriut?

Dinjiteti dhe barazia e të gjithë anëtarëve të racës njerëzore si dhe shumë parime të tjera bazë që kanë çuar në lindjen e Të drejtave të Njeriut, mund të gjenden në çdo kulturë, qytetëri, dhe traditë fetare apo filozofike. ("World Ethics" and the "Golden Rule" by Hans Küng).

Kush vendos se cilat janë të Drejtat e Njeriut?

Ideja e të drejtave të njeriut si të drejta të patjetërsueshme dhe të qenësishme të çdo individi për shkak të natyrës së tyre njerëzore ka një histori të gjatë. Filozofët dhe teologët e të gjithë kohërave kanë shprehur tezat dhe idetë e tyre, të cilat janë pjesërisht të përfshira në dokumente të rëndësishëm si Magna Charta, Deklarata amerikane e pavarësisë, Deklarata franceze e të drejtave të individit dhe qytetarit, dhe Deklarata Universale e të drejtave të njeriut e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Formulimi i të drejtave të njeriut kështu siç ne i njohim sot është një vendim i përbashkët i racës njerëzore dhe pasojë e një procesi evolutiv të vazhdueshëm e të gjatë të ideve të lirisë të të gjitha qënieve njerëzore.

Kur u adoptua nga OKB-ja Deklarata Universale e të drejtave të njeriut?

Deklarata Universale e të drejtave të njeriut dhe 30 artikujt e saj u adoptuan nga OKB-ja më 10 dhjetor 1948 pranë pallatit Chaillot në Paris. Çdo viti, 10 dhjetori festohet si dita e të drejtave të njeriut për të përkujtuar adoptimin e Deklaratës.

Cilet individë dhanë kontributin kryesor në redaktimin e Deklaratës?

Eleanor Roosevelt (SHBA), René Cassin (France), Charles Malik (Liban), Peng Chun Chang (Kinë), Hernan Santa Cruz (Kili), Alexandre Bogomolov/Alexei Pavlov (Bashkimi Sovietik), Lord Dukeston/Geoffrey Wilson (Mbretëri e Bashkuar), William Hodgson (Australi) and John Humphrey (Kanada).

Pse Kombet e Bashkuara përgatitën dhe adoptuan Deklaratën Universale?

Lufta e II Botërore dëshmoi që dhunimet e shumta të të drejtave të njeriut çuan në thyerjen e paqes ndërkombëtare. Tmerret e kësaj lufte konfirmuan dhe forcuan bindjen që njohja e dinjitetit dhe të drejtave të barabarta e të patjetërseshme të të gjithë njerëzve qëndron në bazë lirisë. Drejtësisë dhe paqes në të gjithë botën. Hapi më i rëndësishëm drejt redaktimit të një karte ndërkombëtare të të drejtave të njeriut u hodh më 10 dhjetor 1948 atëherë kur Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara adoptoi Deklaratën Universale si një standard i përbashkët për realizimin e të drejtave të të gjithë popujve dhe kombeve.

Kujt i aplikohet Deklarata Universale?

Deklarata i aplikohet çdo individ në tokë, burra, grua apo fëmije, pa dallim gjinie, race, feje apo karakteristikash të tjera.

A janë të drejtat e njeriut një fenomen i relativisht i ri?

Të drejtat e njeriut nuk u shpikën në momentin kur u adoptua Deklarata Universale në 1948. I Diritti Umani “non furono serviti su un piatto” quando la Dichiarazione Universale dei Diritti Umani fu adottata dall’ONU nel 1948. Lëvizja për pretendimin, themelimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut ka një histori të gjatë. Përgjatë shekujve në të gjithë botën njerëz të thjeshtë dhe të jashtëzakonshëm – burra, gra, mendimtarë, mësues, organizatorë, shkrimtarë, dhe reformatorë – me prejardhje nga kultura, ide politike apo fetare të ndryshme kanë luftuar, në emër të lirisë, drejtësisë, dhe demokracisë, kundër shtypjes për pavarësinë e kombeve dhe barazinë. Këta individë nisën levizjet sociale që ndryshuan botën. Disa prej mbrojtësve të të drejtave të njeriut kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin jetën e tyre për këtë kauzë.

A janë të drejtat e njeriut një shpikje “përëndimore”?

Deklarata Universale u redaktua dhe adoptua nga një komision të përbërë nga burra shteti dhe përfaqësues shtetesh kryesisht nga SHBA dhe Evropa. Kishte vetëm një përfaqësues për Azinë, Afrikën, dhe Lindjen e Afërme. Nëpërmjet Deklaratës, shtetet nënshkruese kërkonin mbrojtjen e të drejtave të njeriut të të gjithë njerëzve, pavarësisht fesë, racës, kulturës apo traditës së tyre. Parimet e afirmuara në Deklaratë mund të realizohen nga çdo shtet, qeveri dhe fe në botë. E drejta e jetës, ndalimi i torturës dhe trajtimeve të tjera çnjerëzore degraduese, e drejta e qytetarisë, liria e shprehjes dhe opinionit, e drejta për të lënë dhe për të hyrë në shtetin e origjinës, e drejta për të kërkuar azil politik në rast persekutimi, mund të garantohen nga të gjitha qeveritë e botës.

A është Deklarata Universale i vetmi instrument ekzistues për mbrojtjen e të drejtave të njeriut?

Që nga momenti i adoptimit të Deklaratës Universale nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së janë adoptuar mbi 80 konventa universale apo rajonale detyruese për shtetet anëtare, pra që përbëjnë parime detyruese të sistemeve politike.

Disa nga konventat më të rëndësishme janë:

- Pakti ndërkombëtar mbi të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (ICESCR 1966),
- Pakti ndërkombëtar mbi të drejtat civile dhe politike (ICCPR 1966) dhe protokolli fakultativ i ICCPR që lejon individët të denoncojnë dhunimet e të drejtave të parashikuara nga paktet.

Protokolli i dytë fakultativ mbi heqjen e dënimit me vdekje. Nga 1976, 130 shtete kanë nënshkruar paktet. Protokolli i parë është ratifikuar nga 90 shtete dhe i dyti nga rreth 30.

- Pakti mbi parandalimin dhe ndëshkimin e krimit të gjenocidit (1948)
- Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut dhe protokollet shtesë (1950)
- Konventa mbi statusin e personave pa shtetësi (1954)
- Deklarata mbi të drejtat e fëmijës (1959)
- Karta sociale evropiane (1961)
- Pakti mbi statusin e refugjatit (1961)
- Konventa mbi eliminimin e çdo forme diskriminimi racor (1965)
- Konventa Amerikane mbi të drejtat e njeriut (1969)
- Konventa mbi eliminimin e çdo forme diskriminimi ndaj grave (CEDAW 1979)
- Karta Afrikane mbi të drejtat e njeriut dhe popujve (1981)
- Konventa kundër torturës dhe ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose degraduese (1987)
- Konventa mbi të drejtat e fëmijës (1989)
- Karta e të drejtave të njeriut e Bashkimit Evropian (2000)

Çfarë është Karta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut?

Deklarata Universale, Pakti ndërkombëtar mbi të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore dhe Pakti ndërkombëtar mbi të drejtat civile dhe politike formojnë së bashku atë që quhet Karta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut.

Cili është ndryshimi ndërmjet Deklaratës Universale dhe Pakteve ndërkombëtare?

Paktet, ndryshe nga Deklarata, janë traktate dhe për këtë arsye janë detyruese për vendet që i kanë nënshkruar të cilët kanë detyrimin për të respektuar procedurat e nevojshme për implementimin e tyre, përfshirë dërgimin e raporteve periodike mbi implementimin. Deklarata Universale, ndryshe nga paktet, është vetëm një rekomandim për të respektuar dhe promovuar të drejtat e njeriut. Edhe pse në fillimet e saj ajo kishte vetëm vlerë morale, sot mund të themi që ajo ka marrë statusin e së drejtës zakonore ndërkombëtare të detyrueshme për të gjitha shtetet e botës.

Kush e kontrollon zbatimin e pakteve nga shtetet nënshkrues?

Shtetet që kanë ratifikuar Paktin mbi të drejtat civile dhe politike emërojnë një Komitet për të drejtat e njeriut të përbërë nga 18 anëtarë me kompetencë të njohur në fushën e të drejtave të njeriut. Anëtarët e këtij komiteti veprojnë si individë dhe jo si përfaqësues të shtetit prej nga vijnë.

Sa eficient është ky sistem?

Meqenëse mbrojtja e të drejtave të njeriut varet gjithsesi nga shtetet, fuqia që ka Komiteti për të drejtat e njeriut është fatkeqësisht e kufizuar. Sidoqoftë puna e Komitetit është me vlerë sepse vlerësimi i raporteve bëhet në mënyrë publike dhe Shtetet janë të ndjeshëm kundrejt ekspozimit publik të situatës të të drejtave të njeriut në vendet e tyre, pra i “tremben” faktit që mund të shpallen publikisht si shkelës të të drejtave. Për më tepër një nga detyrat kryesore të Komitetit është dhe zhvillimi i një dialogu konstruktiv me shtetet për të promovuar konformimin e tyre me dispozitat e Pakteve.

Çfarë ishte Komisioni për të drejtat e njeriut i OKB-së?

Komisioni për të drejtat e njeriut është organizmi i OKB-së që merret kryesisht me problematikat e të drejtave të njeriut. Ai është i formuar nga të deleguarit e 53 vendeve që përfaqësojnë të gjitha zonat e botës. Vendet që përfaqësohen në këtë komision seleksionohen nga Këshilli Ekonomik dhe Social, i cili

mban parasysh shpërndarjen gjeografike. Komisioni mbledhet në Gjenevë për një kohëzgjatje prej 6 javësh çdo vit.

Çfarë është Këshilli për të drejtat e njeriut i OKB-së?

Në 2006, Komisioni për të drejtat e njeriut u transformua në Këshilli për të drejtat e njeriut. Këshilli ka selinë në Gjenevë dhe funksionon si një organ ndihmës i Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së dhe punon në lidhje të ngushtë me Komisaratin e lartë të OKB-së për të drejtat e njeriut. Këshilli ka si qëllim mbikqyrjen e respektimit dhe të dhunimeve të të drejtave të njeriut në të gjitha shtetet anëtare të OKB-së dhe informimin e opinionit publik botëror mbi situatën e të drejtave të njeriut në botë.

Cila zyrë e Kombeve të Bashkuara është përgjegjëse në fushën e të drejtave të njeriut?

Komisariati i lartë i OKB-së për të drejtat e njeriut (UNHCHR) është agjencia e OKB-së përgjegjëse për të drejtat e njeriut. Agjencia drejtohet nga Komisari për të drejtat e njeriut i cili koordinon aktivitetet mbi të drejtat e njeriut në të gjithë OKB-në dhe mbikqyr Këshillin për të drejtat e njeriut.

A mundet një individ viktimë e shkeljeve të kontaktojë drejtpërdrejt zyrën e Komisarimit të Lartë?

Po! Ka një linjë fax të disponueshme 24 orë në ditë (+41 22 91 700 92) e cila mund të përdoret nga viktimat e shkeljeve, të afërmit e tyre apo organizatat jo qeveritare.

A ekzistojnë organizma rajonale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut?

Përveç OKB-së janë edhe 3 organizata rajonale të cilat kujdesen për të drejtat e njeriut dhe mbajnë institucione të përhershme me këtë qëllim: Këshilli i Evropës; Organizata e Bashkimit Afrikan; dhe Organizata e Shteteve Amerikane. Që të tre këto organizata kanë krijuar instrumente dhe traktate të bazuara mbi Deklaratën Universale.

Çfarë është Këshilli i Evropës?

Këshilli i Evropës është një organizatë ndërqeveritare që ka si qëllim:

- mbrojtjen e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe shtetit të së drejtës;
- promovimin e indentiteve dhe diversitetit kulturor;
- gjetjen e zgjidhjes së problemeve të shoqërisë evropiane (diskriminimin e pakicave, ksenofobinë, intolerancën, mbrojtjen e ambientit, Sidën, drogën, kriminalitetin etj);
- konsolidimin e stabilitetit demokratik në Evropë duke mbështetur reformat politike, legjislative dhe kushtetuese. Çdo shtet Evropian mund të bëhet anëtar i Këshillit me kusht që të pranojë parimin e shtetit të së drejtës dhe garantimin e të drejtave të njeriut dhe liritë themelore për të gjithë. Kujdes! Këshilli i Evropës nuk duhet ngatërruar me Bashkimin Evropian, edhe pse të gjitha shtetet anëtare të BE-së janë pjesë e Këshillit.

Çfarë është Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut (KEDNJ)?

Këshilli i Evropës i themeluar në 1949 redaktoi një instrument për mbrojtjen e të drejtave të njeriut: Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe liritë themelore. KEDNJ u redaktua në 1950 dhe hyri në fuqi më 3 shtator 1953. Konventa trajton kryesisht të drejtat civile dhe politike dhe në preambul afërmon: “Të vendosura, si qeveri të shteteve evropiane, që shtyhen nga e njëjta frymë dhe që kanë një trashëgimi të përbashkët idealesh, traditash politike, lirie dhe shteti të së drejtës, për të marrë masat fillestare për zbatimin e përbashkët të disa prej të drejtave të shpallura në Deklaratën Universale”. Gjykata Evropiane e të drejtave të njeriut, Komisari për të drejtat dhe Komiteti i Ministrave garantojnë të

drejtat e parashikuara në konventë. Shtetet anëtare kanë ndryshuar ligjet e tyre të brendshme me qëllim përshtatjen me konventën.

KEDNJ është ligj?

Po dhe jo. Në Austri psh, Konventa është kthyer automatikisht në ligj. Në Gjermani konventa është ratifikuar nga Parlamenti. Edhe në vendin tonë Konventa u ratifikua nga Parlamenti me ligjin n. 8137 në 1996. Në Shqipëri, kur një konventë ndërkombëtare ratifikohet me ligj, ajo ka përparësi ndaj ligjeve vendase në kundërshtim me të. Pra, konventa nuk është automatikisht ligj, por shtetet kanë detyrimin për ta integruar atë në legjislacionin e brendshëm.

Cilat organizata ndërqeveritare të tjera merren me të drejtat e njeriut?

Një nga organizatat ndërqeveritare me interes të veçantë për të drejtat e njeriut është Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE) e cila filloi aktivitetin e saj me 1970 si një pikë takimi ndërkulturor me qëllim dialogun dhe negocimin midis lindjes dhe perëndimit. Me Aktin Final të Helsinkit shtetet vendosën parimet që do të respektoheshin lidhur me raportet midis shteteve dhe raportet midis qeverive dhe qytetareve të saj. Në takimet e mëpasshme shtetet vendosën disa detyrime për respektimin e të drejtave të njeriut si psh mbrojtja e pakicave, parandalimi i torturës, liria e shprehjes, dhe heqja e dënimit me vdekje. Zyra e Institucioneve demokratike dhe të drejtave të njeriut (ODIHR) promovon të drejtat e njeriut, demokracinë, dhe shtetin e së drejtës dhe ndihmon shtetet në implementimin e angazhimeve lidhur me të drejtat e njeriut.

Çfarë roli luajnë organizatat jo qeveritare (ONG) në mbrojtje të të drejtave të njeriut?

OJQ kontribuojnë në mënyrë domethënëse në programin e OKB-së mbi të drejtat e njeriut. Këto lloj organizatash shërbejnë si burim informacioni, ndihmojnë në ngritjen e standardeve të reja, ndihmojnë në marrjen e masave për viktimat e shkeljeve, dhe luajnë një rol tepër të rëndësishëm në edukimin e të drejtave të njeriut, sidomos në nivel jo formal. Ekzistojnë OJQ të ndryshme lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare që merren me të drejtat e njeriut, dhe nga më të rëndësishmet është padyshim Amnesty International. Kjo organizatë është themeluar në 1961 dhe është nderuar me çmimin Nobel për Paqen në 1977 për impenjimin e saj në favor të lirisë së fjalës dhe të fesë, të lirisimit të të burgosurve politikë, dhe të betejës kundër torturës, dënimit me vdekje, intolerancës dhe diskriminimit.

Cilat janë kushtet paraprake për zbatimin efektiv të të drejtave të njeriut?

Zbatimi efektiv i të drejtave të njeriut kërkon që individët të jenë të ndërgjegjshëm për të drejtat e tyre dhe të tjerëve në mënyrë që të jenë në gjendje të kërkojnë implementimin e tyre. Pra, njohja e të drejtave të njeriut dhe mënyrat për t'i mbrojtur ato përbëjnë një kusht paraprak themelor për të garantuar implementimin efektiv. Edukimi me të drejtat e njeriut kontribuon në mënyrë domethënëse për arritjen e këtij objekti.

Si e promovon komuniteti ndërkombëtar edukimin me të drejtat e njeriut?

Ekzistojnë disa rezoluta për mësimin e të drejtave të njeriut, si psh, Deklarata e Vjenës dhe Programi i Aksionit (1993) bazuar në Planin botëror për edukimin me të drejtat e njeriut dhe demokracinë. Edukimi me të drejtat e njeriut është pjesë e rëndësishme e aktivitetit të OKB-së me qëllim arritjen e paqes. Me rezolutën 1994/51 Komisioni i të drejtave të njeriut i kërkoi Asamblesë së Përgjithshme shpalljen e dhjetëvjeçarit për edukimin me të drejtat e njeriut 1995-2004. Objektivat e këtij dhjetëvjeçari ishin:

- vlerësimi i nevojave dhe formulimi i strategjive efikase për promovimin e mësimin të të drejtave të njeriut në çdo nivel.

- realizimin dhe fuqizimin e programeve dhe kompetencave për edukimin e të drejtave të njeriut në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- zhvillimin e koordinuar të materialeve didaktike mbi të drejtat e njeriut.
- konsolidimin e rolit të mass mediave në promovimin e edukimit me të drejtat e njeriut.
- përhapjen globale të Deklaratës Universale në sa më shumë gjuhë të ndryshme dhe në forma të përshtatshme me nivele të ndryshme alfabetizimi.